

Krejt çka u gjet në veri, Hoxha: Policia shoqëroi një person



28/02/2025 18:59

f

t

e


Drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka dhënë detaje për armatimin e gjetur sot në Radel të Leposaviqit.

Hoxha tha se operacioni akoma po vazhdon dhe se deri më tani është shoqëruar një person që po intervistohet.

“Tani po jap listën e provave. Një pushkë, kondak pushke, 19 fishekë për pistoletë, një çantë me 49 fishekë për armë të gjatë, 1 palë dylbi për snajper, 11 fishekë për armë gjuetie, 1 çantë me 4 karikator të zbrazët, një pjesë për tytë, dhe një kuti me vaj”. “Pajisje për pastrimin e armës, dy gazmaska, pajisje ushtarake për ushqim, çantë për ndihmë të parë, qese për pajisje dhe ndihmë të parë, dy vula, literaturë të ndryshme, çantë me dokumente, substancë të dyshuar të eksplozivit, telefona, dylbi, dy shigjeta, substancë e dyshuar e eksplozivit, thikë, karikator i zbrazët, disa çanta ushtarake, jakne me mbishkrime si dhe 31-40 uniforma ushtarake të ndryshme, ku në mesin e tyre një është e organizatës ‘Mbrotja Civile’”, tha Hoxha.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LupaMedia



Artikuj të ngjashëm



March 1, 2025

Ish prokurorja Hajdari: Koha po e rrezikon adresimin e krimeve të luftës

Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information